

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Balla akuzon Berishën: Takove rusin që hartoi raportin kundër UÇK-së, punove kundër Hashim Thaçit! T eatrot se jeni atdhetarë, lërini për ditë tjetër - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/balla-akuzon-berishen-takove-rusin-qe-hartoi-raportin-kunder-uckse-punove-kunder-hashim-thacit-teatrot-se-jeni-atdhetare-lerini-per-dite-tjeter
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:45:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:42:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	65f90f4eed0663e12a75d68a479a90e4b9ad0a0adca93c59463adb9ab8717d5b
TEKSTI	2e76fbdbb639ffb12cf7cd124ec0bec55a9d51ca5b67cb5140bc293b4a2fcb0f
PAMJA	69630636d9b8c90f718d9f146a037745da1fce6a1daec72c2c95e45b754c397f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	776eec443670238dc0815ba0d30530665cdc3ab455507cc32788eccc8cf2853e
E MËPARSHMJA	073c58b18fc7611f0ae22e8d74b19ed3926c7515cf71e84a340fea8edaa543d7
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/776eec443670238dc0815ba0d30530665cdc3ab455507cc32788eccc8cf2853e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Flutura Ačka shpërthen ndaj Bardhit: Me mua u sollë si fashist! Preve në besë miqtë dhe ike



Politikë

Balla akuzon Berishën: Takove rusin që hartoi raportin kundër UÇK-së, punove kundër Hashim Thaçit! Teatrot se jeni atdhetarë, lërinë për ditë tjetër



Redaksia

17 Shtator, 15:42 | Përditësimi: 17 Shtator, 16:47

f Share Tweet

A A

Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla akuzoi Sali Berishën se ka punuar kundër Hashim Thaçit dhe ka takuar rusin që hartoi raportin që i hapi rrugë ngritjes së Gjykatës Speciale. Nga foltorja e Kuvendit, Balla tha se Berisha është i vetmi deputet që ka takuar Konstantin Kosachev. Balla tha se Rama ka luftuar më shumë se kushdo për pafajësinë e ish-krerëve të UÇK-së.



"I bashkohem falënderimit të kryetarit të Kuvendit për dakordësinë që arritëm në deklaratën e sotme, shenjë pjekurie politike dhe përgjegjësie të madhe. Të gjithë sekretarët me radhë marrin fjalën, dalin tej deklaratës së përbashkët dhe drejtojnë gishtin për fajësi, për përgjegjësi politike të mazhorancës dhe kryeministrit, edhe pse besoj se biem të gjithë dakord që, në ka një ndër ne 140 deputetët e Kuvendit që ka luftuar më shumë për pafajësinë e çlirimtarëve, ai quhet Rama.

Në anën e kundërt të historisë, në ka një person që, të paktën ndaj Hashim Thaçit, ka qenë më agresiv, më i dëmshëm, është Sali Berisha, sepse e dini fare mirë deklaratën e tij publike se Thaçi duhet të shkojë në Hagë, ku duhet të pastrohet.



LEXO EDHE:

Preç Zogaj: Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

I vetmi në këtë sallë që e ka takuar iniciuesin, shkruasin e këtij raporti, rusin Konstantin Kosachev, ai quhet Sali Berisha. Nuk ka një të dytë që ta ketë takuar. E ka takuar vetëm 40 ditë nga 25 janari i vitit 2015, kur është votuar rezoluta në KiE, kur kjo parti ka qenë në anën e duhur të historisë, ndërsa ju keni votuar pro rezolutës që ngriti gjykatën në Kosovë. Këto teatrot se ju jeni atdhetarët, se ne qenkemi tradhtarët, lërinë për një kohë tjetër", tha Balla.

Fjala e Ballës erdhi pasi Kuvendi doli me një deklaratë të përbashkët kundër dënimit të Hagës për liderët e UÇK-së, ndërsa opozita më herët kishte akuzuar kryeministrin Edi Rama se i futi thikën pas shpine Kosovës.

Lajmi kryesor:

Dënimet në Hagë të UÇK, Kuvendi i Shqipërisë me deklaratë të përbashkët: Vendim i padrejtë, një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli

SI.E/E.H/Shqiptarja.com

TAG: [Kuvend 17 shtator 2026](#) [Gjyqi ndaj UCK ne Hage](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



3.7 / 5 (3 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA



Ndalohej rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera

Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpaloset flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-krerët e UÇK (VIDEO)

20 Shtator, 21:28



Dënimi me 81 vite burg i 4 ish-krerëve të UÇK, shqiptarët protestë edhe në Vjenë të Austrisë: O Hashim, ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke! (VIDEO)

20 Shtator, 16:25



Njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

20 Shtator, 15:11



Verdikt i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interperlancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?

20 Shtator, 13:40



A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë

20 Shtator, 08:54



5 ditë pas vendimit të Hagës, Prishtina sërish në shesh: Na ka bashkuar UÇK-ja! Tubime edhe në Gjermani, Zvicër, Austri e Kanada (VIDEO)

20 Shtator, 07:15



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43



Pandeli Majko: Ku gabuam...?



Pandeli Majko

19 Shtator, 19:22



Adri Nurellari: Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi, çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën



Adri Nurellari

19 Shtator, 18:58



Kosovë/ Hamza viziton familjet Thaçi, Veseli dhe Krasniqi: Do të vazhdojmë betejën për drejtësi deri në kthimin në atdhe të luftëtarit të fundit të lirisë

19 Shtator, 18:49

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.